

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga **MERKATOR-CG D.O.O. Podgoricë** (MERCATOR-CG D.O.O. Podgorica), me seli në rrugën Put Radomira Ivanovica nr. 2, Podgoricë, Mali i Zi, përmes Shoqërisë së Avokatëve Polenak nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 05.12.2022, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin **MERKATOR-CG D.O.O. Podgoricë** (MERCATOR-CG D.O.O. Podgorica), me seli në rrugën Put Radomira Ivanovica nr. 2, Podgoricë, Mali i Zi, synon të fitoj kontrollin e vetëm mbi një shoqëri të sapoformuar për qëllime speciale që do të marrë përsipër biznesin e shitjes me pakicë të FRANCA MARKETI SHPK Bijelo Polje (FRANCA MARKETI DOO Bijelo Polje), me seli në rr. Svetog Petra Cetinjskog BB Bjelo Polje, Mali i Zi, nëpërmjet blerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 11.11.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftimi për përqendrim nga **MERKATOR-CG D.O.O. Podgoricë** (MERCATOR-CG D.O.O. Podgorica), me seli në rrugën Put Radomira Ivanovica nr. 2, Podgoricë, Mali i Zi, me të cilin **MERKATOR-CG D.O.O. Podgoricë** synon të fitoj kontrollin e vetëm mbi një shoqëri të sapoformuar për qëllime speciale që do të marrë përsipër biznesin e shitjes me pakicë të FRANCA MARKETI SHPK Bijelo Polje (FRANCA MARKETI DOO Bijelo Polje), me seli në rr. Svetog Petra Cetinjskog BB Bjelo Polje, Mali i Zi, nëpërmjet blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Aktiviteti i regjistruar i **Merkator-CG** është – Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara.

Merkator-CG është pjesë e Grupit Fortenova, aktiviteti kryesor i të cilit është shitja me pakicë e mallrave të përditshme për konsum të gjerë për konsumatorët e fundit përmes një rrjeti dyqanesh me pakicë në të gjithë Slloveninë, Bosnje dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zi.

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime **MERKATOR MACEDONIA SHPKNJP Shkup**, me seli në Ognjen Prica 1/3-28 kat i ndërmjetëm, Shkup, Kisella Voda, Maqedonia e Veriut është shoqëri e varur e Grupit Fortenova e regjistruar në Maqedoninë e Veriut, e cila merret me tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara kryesisht me ushqime, pije dhe duhan, por nuk është më aktive në treg.

Aktiviteti i regjistruar i **Franza Marketi** është - tregti tjetër me pakicë e ushqimeve në dyqane të specializuara.

Transaksioni i propozuar i referohet blerjes së biznesit të shitjes me pakicë të **FRANCE MARKETI SHPK Bijelo Polje**, për qëllimin e të cilit ortakët e FRANCE MARKETI do të themelojnë një kompani për qëllime të veçanta të cilës do t'i transferohet biznesi me pakicë i FRANCE MARKETI, dhe më pas Merkator- CG do të blejë 100% të pjesëve në shoqërinë për qëllime të veçanta.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски